



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2022:054011

Datë: 30.08.2024

Numri i dokumentit: 06104281

P.nr.73/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi në çështjen penale kundër të pandehurit V.D. nga Vushtrria, te cilin sipas autorizimit e mbron av. R.M. për shkak të veprës penale *Deklarimi i rremë* nga neni 384 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 2150/21 të datës 23.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik të datë 06.08.2024, në praninë e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij në të njëjtën datë, mori dhe shpalli kurse me dt. 30.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: V.D., nga babai Rr... dhe nëna Sh..., e vajzërisë K..., i lindur më ..., në Vushtrri, me vendbanim në fshatin ..., rrugën "...", nr. ..., Vushtrri, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Më datë 01.12.2021, ne objektin e Komunës së Vushtrrisë, ne shërbimin për dhënien e pasaportave ka bërë deklaram te rremë se e ka humbur pasaportën paraprak te cilin e ka pasur me nr. P01747449, lëshuar nga MPB –Vushtrri, edhe pse i njëjti nuk e ka humbur por qe i ishte konfiskuar nga ana e policisë me dt. 31.08.2021, pasi qe kishte poseduar lejen e qëndrimit Belge te falsifikuar, kështu qe ka tentuar qe te pajiset me pasaportë te re, por qe me rastin e verifikimit nga organet kompetente te shërbimit, ishte konstatuar se pasaporta nuk i ka humbur por i ishte konfiskuar si objekt i kryerjes se veprës penale.

Më këtë ka kryer veprën penale *Deklarimi i rremë* nga neni 384 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 21, 42, 43, 48, 69, 70 dhe nenit 384 par.1 të KPRK-se, si dhe në bazë të nenit 364, 452 dhe 462 të KPP-së të pandehurit i shqipton:

#### DENIM ME GJOBË

Me të cilin të pandehurit gjykata i shqipton dënim me gjobë në shumen prej 300€ (treqind euro) i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe kumulativisht,

#### DENIM ME KUSHT

Me të cilin të pandehurit gjykata i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në periudhën verifikuese prej një viti nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale.

DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 30€ (tridhjetë euro), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 20€ (njëzet euro).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

#### A r s y e t i m

##### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 2150/21 të datës 23.03.2022, kundër të pandehurit V.D., me vendbanim në Vushtrri, për shkak të veprës penale Deklarimi i rremë nga neni 384 par.1 të KPRK-se.

Gjykata me datë 06.08.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale.

##### *Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar*

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 06.08.2024, pasi që gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë ku i pandehuri ka deklaruar se pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës dhe ka shtuar se i vjen keq për atë që ka bërë, e ka kuptuar se në të ardhmen nuk duhet të bëjë veprime të tilla, kjo nuk ka ndodhur më parë dhe është hera e parë që është në gjykatë.

Pas pranimit të fajësisë, gjyqtari i vetëm gjykues edhe njëherë e ka njoftuar të pandehurin me favorin dhe disfavorin e pranimit të fajësisë dhe me dispozitat e KPRK-se, por edhe pas kësaj i pandehuri ka deklaruar se dëshiron ta pranojë fajësinë në mënyrë vullnetare.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit ka deklaruar se i propozon gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që si i tillë ky deklarim i tij është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, e që janë prova të ligjshme të marra nga prokurori i shtetit. Në rast se gjykata aprovon fajësinë e të pandehurit, gjykatës i ka propozuar që me rastin e marrjes së vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit të marrë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, keqardhjen e shprehur nga ana e të njëjtit, pendimin dhe premtimin se nuk do të përsërisë më vepra të njëjta apo tjera penale, faktin se i njëjti nuk ka të kaluar kriminale, ndërsa si rrethanë rënduese ti merret fakti se deklarimi i rremë i bërë nga ana e tij ka të bëjë më një dokument identifikues siç është pasaporta çka edhe nga përshkrimi i gjendjes faktike rezulton se i pandehuri me veprimet e tij ka konsumuar një shkallë të lartë të dashjes, andaj gjykatës i kërkohet që këto rrethana ti ketë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit av. R.M., lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit ka deklaruar se para fillimit të seancës me të mbrojturin e tij ka biseduar lidhur me veprën penale me të cilën ngarkohet andaj edhe i njëjti në këtë seancë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime e pranojë në tërësi veprën penale për të cilën akuzohet, për veprën penale të cilën e ka kryer pendohet, premtonte se në të ardhmen nuk do të bie në kundërshtim me ligjin dhe me rastin e shqiptimit të dënimit gjykatës i ka propozuar që ndaj të njëjtit ti shqiptohet një dënim i kushtëzuar, se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen i mbrojturi i tij të mos bie në kundërshtim me ligjin. Tutje mbrojtësi ka theksuar se është fakt se që nga momenti i kryerjes së veprës penale në vitin 2021 e deri më sot ka kaluar edhe një kohë e gjatë çka do të thotë se i pandehuri nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin asnjëherë duke pretenduar se edhe kjo përbën një rrethanë lehtësuese në favor të të pandehurit.

#### *Vlerësimi i gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë është në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së, kjo pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

#### *Provat e vlerësuara nga gjykata*

Gjykata pranimin e fajësisë nga i pandehuri e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 242 të KPP-se, dhe ka konkluduar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimin mbi fajësinë nga i pandehuri sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: raporti policor i dt. 02.12.2021; raporti i oficerit dt. 02.12.2021; procesverbali i marrjes në

pyetje te te pandehurit ne prokurori dt. 02.12.2021; raporti mbi verifikimin e dokumenteve te humbura dt. 16.10.2001; deklarata mbi humbjen e dokumentit dt. 16.10.2021, si dhe shkresat e tjera te lendes.

### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale *Deklarim i rremë* nga neni 384 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 384 par.1 të KPRK –së është parashikuar se forma themelore e veprës penale kryhet kur “Pala, dëshmitari, eksperti në cilësi të dëshmitarit, përkthyesi apo interpreti i cili në procedurën gjyqësore ose penale, procedurën paraprake, në procedurën për kundërvajtje, në procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore jep deklaratë, ekspertizë ose raport të rremë dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.”

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje me të gjitha provat në shkresat e lëndës, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale *Deklarim i rremë* nga neni 384 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Kodi Penal i Republikës së Kosovës për veprën penale *Deklarim i rremë* nga neni 384 par.1 të KPRK-së, ka paraparë dënimin me gjobë dhe burgim deri në një vit.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 38, 69, dhe 70 të KPRK-së, gjykata ka marrë parasysh por pa u kufizuar ne rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur nga ana e të pandehurit, dhe faktin se i pandehuri nuk evidentohet si kryes i ndonjë veprë penale. Kurse sa iu përket rrethanave renduese gjykata mori parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur kurse rrethana tjera renduese gjykata nuk gjeti.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar me gjobë dhe me vërtetimin e dënimit me burgim si ne dispozitiv, ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës, dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 449 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartcekurat e bazuar në nenin 364 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr. 73/22 datë 30.08.2024

Zyrtarja ligjore  
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Ferki Xhaferi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.